

**KULTURA MATERIALE E REGJIONIT TË LLAPIT  
NË PARAHISTORI DHE NË ANTIKË**

*Edi Shukriu*

Fakulteti Filozofik  
Prishtinë

KUD 902/904 (497.115)  
Punim studimor

Marrë për botim më 14 shtator 1989.

Në punim bëhet fjalë për ecuritë dhe zhvillimin e kulturës materiale në regjionin e Llapit gjatë parahistorisë dhe antikës. Autori shfrytëzon të dhënat nga rekognoscimi arkeologjik dhe pjesërisht ato nga hulumtimet në Gllamnik e Teneshdoll.

Mikroregjioni i Llapit shtrihet në pjesën qendrore të Ballkanit, në vendtakimin e maleve masive të sistemit dinarik, të Sharrit e të Pindeve dhe të Rodopeve e të Ballkanit. Këto përkohën me lumenj e me lugina të cilat shërbyen si rrugë natyrore për kontakte në mes të hapsirave më të gjëra gjeografike gjatë mijëvjeçarëve. Ultësira e rrjedhës së Llapit dhe e rrjedhës së Batllavës kishin rol të rëndësishëm. Në varësi të ngushtë me pozitën e tillë gjeomorfologjike u zhvilluan edhe ecuritë parahistorike e historike të kësaj treve, duke e përfshirë dhe këtë në rrjedhat e përgjithshme të kohës.

Pjesët e ulëta të Llapit ishin nën ujë deri në fund të diluviut, kur u tërhoq liqeni, i cili gjatë epokës së terciarit ishte një ndërlidhje në mes të ujërave të Panonisë dhe të Egjeut.<sup>1</sup> Për këtë, strehimoret apo shpellat e mundshme të banorëve të epokës më të hershme të zhvillimit të kulturës materiale e shpirtërore të njerëzimit, të paleolitit, duhet kërkuar në pjesët malore. Në Llap dhe në rrethinën e Prishtinës duken teracat aluviale, të cilat u formuan gjatë tërheqjes së ujërave të liqenit. Konfiguracioni i tillë i terrenit, rrugët të cilat shpienin nëpër të dhe pasuritë natyrore që i mbante në gji, ndikuan që regjioni të jetë i përshtatshëm dhe joshës që në të të vendosen banorët gjatë epokave vijuese.

<sup>1</sup> J. Cvijić, *Osnove za geografiju i geologiju Makedonije i Stare Srbije*, III, Beograd 1911, 933-934.

## Parahistoria

Gjurmët më të herëshme parahistorike në regjionin e Llapit janë zbuluar në afërsi të fshatit Sibovc i Epërm dhe i takojnë epokës së vonë të gurit-neolitit. Kultura materiale e këtij vendbanimi rrafshinor e zbuluar gjatë rekognoscimit arkeologjik, i përket grupit kulturor të starçevës (që nga viti 5500 p. e. s.). Kjo kulturë shtrihej në Ballkanin qendror dhe ishte pjesë përbërëse e kompleksit ballkano-anadollik të neolitit të mesëm. Në Kosovë janë hulumtuar vendbanime të ngjashme në Glladnicë (Graçanicë), Runik (Sërbicë), Gjonaj (Prizren), Zhitkoc (Mitrovicë e Titos) etj. Bartësit e kësaj kulture për herë të parë filluan të merren me prodhimtarinë bujqësore, së cilës i përshtatej edhe klima dominuese atlantike, e nxehtë dhe me lagështi. Krahas dukjes së blegtorisë vazhdoi edhe sigurimi i ekzistencës me gjueti dhe me peshkatori.

Lumi Llap i rrethuar me tokë pjellore në teracat aluviale ka lozur rol të rëndësishëm për nismën dhe vazhdimin e jetës. Si në territoret e tjera mbledheshin drithëra në baza të bujqësisë ekstenzive dhe për këtë u bënë vegla të reja të punës, siç ishte shati e sopata prej gurit të latuar me trajta të ndryshme, si dhe mokrat për bluarjen e grurit. Vegjetacioni i bujshëm i kohës u mundësoi banorëve të mbledhnin fryte dhe të gjuanin shtazë, si derra, drerë etj.<sup>2</sup> Varësia nga toka dhe prodhimet e saj e lidhën njeriun neolitik për një vend, për ç'arsye lindën vendbanimet sedentare, zakonisht në rrafshe, pranë rrjedhave të lumenjve. Shtëpitë i bënë prej degëve të thurura e të lyera me llaç, në afërsi të cilave jetonin shtazët e zbutura, si delet, gjedhët, dhitë, derrat etj. Këto ua siguronin mishin, qumështin, leshin e prodhimet e tjera. Duke mos pasur më nevojë ta siguronin ushqimin çdo ditë, njeriu i epokës neolitike fitoi kohë për aktivitete të reja, gjithnjë të lidhura ngusht me nevojat e tija. Risi të kësaj kohe janë edhe njohja dhe aplikimi i teknikës së tjerrjes, endjes e thurjes, e kjo e fundit njihej dhe më parë. Zbulimet e peshojave sverike të bëra prej guri të latuar apo prej dheu në rrafshin e Llapit, dëshmojnë për njohjen e këtyre teknikave nga vendasit dhe për përdorimin e vegjes vertikale edhe në këtë truall. Risi e kohës është edhe prodhimtaria shtëpiake e qeramikës (enë prej balte), me të cilën merreshin gratë. Në lokalitetin e Sibovcit ndeshim enë balte me trajta sverike, me teknikën e zbukurimit monokrom e barbotin, të cilat së bashku me lokalitetet e ngjashme mbajnë në vete shprehjen vetanake të kulturës së starçevës.

Gjatë neolitit të vonë bëhen ndryshime në kulturën materiale si pasojë e ndryshimeve etnike,<sup>3</sup> e që njihet me emërtimin kul-

<sup>2</sup> *Kosova dikur e sot*, Ekonomska politika, Beograd 1973, 71.

<sup>3</sup> M. Garashanin, *Praistorija jugoslavenskih zemalja*, Neolit, Sarajevë 1979, 200 dhe literatura përcjellëse.

tura e vinçës. Kjo kulturë ka shtrirje të njejtë si kultura paraprake, pra ka përfshirë edhe regjionin në fjalë, ndërsa lokalitetet më të njohura të hulumtuara të saj janë „Tjerrtorja” (Prishtinë), „Fafos” e Vallaç (Mitrovicë e Titos). Bartësit e kësaj kulture (faza vinça-tordosh) edhe më tej vareshin nga ekonomia bujqësore e blegtorale. Shtatorët e zbuluara në Barilevë,<sup>4</sup> si dhe objektet e tjera janë dëshmi të kontinuitetit të banorëve neolitikë dhe në fillimet e epokës eneolitike (faza vinça-plloçnik). E ngjashme me zbulimet me lokalitetet „Tjerrtorja”, „Fafos” e Vallaç, me të cilat krijon varijantin kosovar të kulturës së Vinçës.<sup>5</sup> Shtatorja e Barilevës është shprehje e kulturës materiale dhe e asaj shpirtërore. Këto, si dhe zbulimet tjera janë dëshmi e botës së krijuar religjioze dhe e përhapjes së kultit të Nënës hyjneshe të mishëruar në popullatat bujqësore. Shtatorët e gjinisë mashkullore pasqyrojnë botëkuptimet e krijuesve të tyre për ndërlidhjen e patjetërsueshme në mes të jetës e të vdekjes, që kishte si pasojë lindjen e kultit të stërgjyshërve, të lidhur ngusht me lindjen e marrëdhënieve të reja patriarkale të kohës së metaleve.

Krijuesit e kulturës, respektivisht të fazës vinça-plloçnik, e cila e përjetoi lulzimin më të madh mu në trevën e Kosovës në fillim të epokës eneolitike, e njihnin bakrin, që e nxirrnin dhe e përpunonin.<sup>6</sup> Nga hulumtimet e ardhshme duhet të pritët dëshmimi i kësaj veprimtarie edhe në këtë territor të begatshëm me xehe. Një numër të vendbanimeve rrafshinore të tilla i ndeshim të shkatërruara e të djegura në kohën e dyndjeve indoevropiane, gjë që i nxiti vendasit të tërhiqeshin në vendbanime të sigurma kodrinore (si në rastin e lokalitetit Karagaç).

Gërshetimi i traditave neolitike dhe të risive që sollën fiset indoevropiane gjatë filleve të epokës së eneolitit bënë një bazë, mbi të cilën në epokat vijuese u krijuan popujt e njohur të Ballkanit, si ilirët, trakët, mezët e të tjerë. Në këtë territor bartësit e këtyre dyndjeve identifikohen me prezencën e grupit kulturor bubanj-hum. Në Kosovë janë hulumtuar vendbanimet kodrinore në të cilat shtresat më të hershme i takonin këtij grupi, si gradina në Gadimjen e Epërme dhe ajo e Hisarit (Suha Rekë).<sup>7</sup> Zbulimi në Hisar i shtresës kulturore të Badenit me prejardhje nga veriu, dëshmon mbi dyndjet e fiseve nga drejtime të ndryshme, në këtë kohë kryesisht nga lindja e veriu, dhe se treva e Kosovës ishte vendkalim dhe vendtakim i rrymimeve kulturore, falë edhe

<sup>4</sup> N. Sllavkoviç, *Tri nove statuete u zbirci Muzeja Kosova i Metohije*. „Buletin i Muzeut të Kosovës e Metohisë”, VII-VIII, Prishtinë 1969, 306, fot. 3.

<sup>5</sup> M. Garashanin, *v. c.*, 185.

<sup>6</sup> B. Jovanoviç, *Rudarstvo i metalurgija eneolitskoq perioda u Jugoslaviji*, Praistorija Jugoslavenskih zemalja-eneolit, Sarajevë 1979, 33.

<sup>7</sup> J. Todoroviç, *Die grabung Hissar und ihr vertaltum zum Aeneolithicum und der fruhen Bronzenzeit*, Archaeologia Iugoslavica IV, Beograd 1963.

pozitës gjeografike në të cilën gjendet. Për shkak të pasigurisë së krijuar në këtë kohë, të gjitha vendbanimet i ndeshim të vendosura në kodra të përshtatshme për mbrojtje, ndërsa kjo mbrojtje përforcohej me ngritjen e ledheve prej dheu e gardheve mbi to.<sup>8</sup>

Dëshmitë arkeologjike për epokën e bronxit, kur vijuan proceset e etnogjenezës, në trevën e Kosovës janë të mangëta. Zbulimi i varreve të kësaj kohe në tumat e fshatit Ujzë te Rogova e lidh territorin e Dukagjinit me kulturën e Matit e të Gllasincit të epokës së bronxit.<sup>9</sup> Në këtë grup hyjnë edhe varrezat e Rogovës e të Përçevës. Zbulimet në shtresat e vendbanimit rrafshinor në Glladnicë (Graçanicë), janë të lidhura me ecuritë që zhvilloheshin përgjatë rrjedhës së Moravës, e dëshmi për këtë ndeshim dhe në truallin e Llapit në afërsi të fshatit Llugë. Në vendbanimin rrafshinor është zbuluar material arkeologjik që i përket grupit kulturor të Medianës,<sup>10</sup> që duket se ka lozur rol në formimin e dardanëve gjatë kohës së fundit të epokës së bronxit. Numri i vogël i lokaliteteve të hulumtuara, megjithëkëtë, nuk lejon të bëhet një pasqyrë e qartë e ecurive, por, është e sigurt, se në këtë kohë duhet ta kemi parasysh formimin e dardanëve. E. Çabej me të drejtë vëren se dardanët janë formuar „si kombësi më vete... përpara degëzimit”, që do të thotë para shekullit XII p. e. s., kur dardanët i gjejmë në Anadulli dhe kur këta i ndeshim në mbishkrimet e Egjiptit në mesin e emrave të „Popujve të detit” (drdnj).<sup>11</sup>

Dukuri të veçant paraqet nekropoli i shesht Badovc me urna i zbuluar në Bërnice të Poshtme, si dhe ai në *Badovc* te Prishtina, në Varosh te Ferizaj, në Karagaç të Vallaçit te Mitrovica e Titos e në Ulpianë. Grupi kulturor i Bërnices së Poshtme është i njohur vetëm përmes varrezave. Fjala është për ritin e djegëjes së kufo-mave, hiri i të cilave është vendosur në urna të rrethuara zakonisht me gurë të lumenjve. Varre të tilla toloide ndeshen dhe në disa tuma të fazës Kuç i Zi I. Por, karakteri i varrimit në urna përkon me lokalitetet e grupit të Strzhavës së Epërme, respektivisht me dukuritë e epokës së bronxit në Anamoravë (grupi i Paraçinit).<sup>12</sup>

Një trajtim të veçantë dhe me interes paraqesin vendbanimet rrafshinore me veçori të grupit Mediana, në të cilat ka elemente që kanë lidhshmëri me kulturën e më vonshme, që me siguri është dardane. Është fjala për vendbanimet në Glladnicë,

<sup>8</sup> Kjo është dëshmuar nga hulumtimet e bëra në gradinën e Gadimes së Epërme, të cilat i bëri J. Glishiq (Muzeu i Kosovës).

<sup>9</sup> M. Garashanin, *Rogovo „Fushë”, Djakovica, praistorijska nekropola sa humkama*, Arheološki pregled 8, Beograd 1966, 40-42.

<sup>10</sup> I njëjti, *Praistorija jugoslavenskih zemalja*, IV, Sarajevë 1983, 762.

<sup>11</sup> E. Çabej, *Emri i Dardanisë dhe izoglosat shqiptaro-kelte*, Studime gjuhësore, IV Prishtinë 1977, 388.

<sup>12</sup> M. Garashanin, v. c., 774.

Fafos, Nosalë, Karagaç e të tjera, në të cilat kryesisht duken enët me buzë të përvjelura nga brënda, e në të cilat si zbukurim duken ornamentet e bëra me instrument të dhëmbëzuar, që duken si veçori dardane si për nga forma ashtu dhe për nga zbukurimet. Këto vendbanime duhet trajtuar si vendbanime të fazës paradardane, banorët e të cilave për shkaqe ekonomike dhe të pasigurisë së kohës u vendosën në vendbanime të mbrojtura kodrinore, ku i ndeshim gjatë epokës së hekurit.

Në shekullin VIII p. e. s. ekzistonte një kulturë me tipare të krijuara, e cila tani më është e sigurt se i përket dardanëve. Kjo kulturë është zbuluar në vendbanimet kodrinore e në vendvarrimet në tuma si në gradinat në Gadimjen e Epërme, Cërnice, Bëllaçevc, Duboc, Hisar e në tumat në Shirokë e Porodime të Shtimja. Veçori të kësaj kulture dalin enët me buzë të përvjelura nga brënda e broket e të cilat janë zbukuruar me katrorë të vegjël të bërë me një instrument të dhëmbëzuar. Këto janë veçori që nuk duken në qeramikën e zbuluar në tumat e huluntuara në Romajë, Rogovë e Përçevë. Duke pasur parasysh lidhjet me kulturat e epokës së bronzit të Anamoravës dhe të Gllasincit, mund të flitet për një rol të ndërmjëm të trevës së Kosovës. Dardanët, si dhe fqinjët jugorë peonët, si thotë E. Çabej, „si në pikëpamje gjeografike ashtu dhe etnike, kanë pasur me gjasë një pozitë të ndërmjeme midis ilirëve e trakasve”.<sup>13</sup>

Në këtë epokë dardanët njohën përdorimin e hekurit dhe e përdornin atë krahas metaleve të njohura më parë, e që nxjerreshin në vend. Pas kësaj edhe karakteri blegtoral i ekonomisë së tyre i shtyti të ngritnin vendbanime në vende kodrinore, në pika të rëndësishme strategjike duke krijuar në këtë mënyrë një sistem vrojtues, mbrojtës e komunikativ në mes tyre. Këtij sistemi i kanë takuar edhe qytezat kodrinore në perëndim të fshatit Llapashticë (kota 833), në perëndim të fshati Lupç i Epërm (kota 760) dhe Kulina të Teneshdolli. Vendbanimi i quajtur „Kulinë”, i cili ngrihet mbi bregun e majtë të lumit Llap, afër Teneshdollit, dëshmon për një vazhdimësi të jetës nga epoka e eneolitit e deri në antikën e vonë. Zbulimet e rastit, e pastaj edhe hulumtimet që i bëri H. Mehmetaj në të, qitën në shesh prezencën e zejtarisë poçare vendase nga shekulli VI p. e. s. me trajta të qeramikës helene. Kjo dëshmon për zhvillimin e forcave prodhuese dardane më heret se shekulli IV p. e. s. si mendohej më parë, si dhe për mundësitë e kontaktimit të dardanëve me fqinjët më të zhvilluar jugor. Këto lidhje janë prezente që në epokën e bronzit, si dëshmojnë gjetjet e shpatave mikenasë në Gllarevë.<sup>14</sup> Ky zhvillim i dardanëve, sidomos nga shekulli VI p. e. s. solli më vonë deri të shfaqja e tyre në skenën politike të Ballkanit nga shekulli III

<sup>13</sup> E. Çabej, v. c., 387-388.

<sup>14</sup> Hulumtimet e K. Lucit në vitin 1988 (Muzeu i Kosovës).

p. e. s. dhe e bëri këtë forcë që rrezikonte kufijt verior të shtetit të Maqedonisë. Pos tjerash zhvillimit të tillë duhet falë dhe eksploatimin e xeheve dhe përpunimin e tyre. Traditën e përpunimit të objekteve prej metaleve të ndryshme e ndeshim në varreza tumulare, për të cilat dëshmojnë edhe burimet e shkruara. Plini (Naturalis historia XXXIII 3, 12) përmend bylyzykët dardanë, të cilët dukeshin edhe në tregjet jasht Dardanisë: „Bile edhe burrat mbajnë në llërën e sipërme të dorës /rrathë ari/ që vinin nga Dardania, dhe prandaj quheshin dardane”.<sup>15</sup>

Nëpër këtë territor në gjysmën e dytë të epokës së hekurit kalonin edhe rrugët e tregtisë në mes të banorëve të brigjeve jugor të Adriatikut dhe të atyre të brendisë së Ballkanit. Kjo duket nga shpërndarja e monedhave të Dyrrahut e të Apollonisë gjatë shekujve III-II p. e. s. deri në Panoni.<sup>16</sup> Perioda prej shekullit IV p. e. s. e deri te pushtimet romake është ende e panjohur në aspektin arkeologjik në Kosovë. Siç dihet nga burimet e shkruara antike kjo është kohë e forcimit të brendshëm të dardanëve dhe e dukjes së tyre në skenën politike të Ballkanit, ku janë edhe rrënjët e interesimit të autorëve antikë dhe të dhënat e shpeshta që ata i japin për dardanët. Nga këta mësojmë edhe për mbretërit dardanë Longarin (rreth vitit 230 p. e. s.), të birin Batonin e Monunin (në fillim të shekullit II p. e. s.).<sup>17</sup>

## Antika

Pushtimet romake dhe përfshirja e kësaj treve në provincën e Mezisë së Epërme (Moesia Superior), që nga viti 44, sollën risi jo vetëm në politikën dhe në mënyrën e organizimit administrativ, por edhe në mënyrën e jetës dhe të krijimit të kulturës materiale. Këto u shprehën më shumë në vendbanimet rrafshinore, pranë rrugëve kryesore e atyre anësore. Në këtë kuptim kultura materiale e shpirtërore, veç veçorive të ruajtura, hyn në suazat e zhvillimit të përgjithshëm të kulturave provinciale romake.

Nëpër rrafshin e Llapit kalonte njëra prej rrugëve të rëndësishme të kohës, e cila lidhte pjesët veriore e brendinë e Ballkanit me brigjet e Adriatikut përmes luginës së Drinit të Bardhë dhe me Egjeun përmes luginës së Lepencit e të Vardarit, ose të rrafshit të Pollogut. Rruga e parë Naissus — Lissus kalonte nëpër Prepollc, Dumnicë të Poshtme, Gllamnik e Lupç i Poshtëm. Në vendbanimet e përmendura gjejmë gjurmë të godinave të kohës romake, qoftë si vendbanime të vogla (vici), qoftë si bujtina

<sup>15</sup> *Ilirët dhe Iliria te autorët antik*, Tiranë 1965, 199.

<sup>16</sup> Z. Dukat — I. Mirnik, *Pre — Roman coinage on the territory of modern Yugoslavia*, Institut of Archaeology Bulletin 13, London 1976, 181.

<sup>17</sup> F. Papazoglu, *Srednjbalkanska plemena u predrimsko doba*, Sarajevë 1969, 139.

(mansiones) apo vende ku shkëmbeheshin kuajt (mutationes). Milienari i zbuluar te Lupçi i Poshtëm është edhe një dëshmi se rruga kalonte në këtë drejtim duke vazhduar për në statio Viciano, prej nga degëzohej në tri drejtime kah Scupi, Theranda dhe Municipium DD (te Soçanica). Një prej vendbanimeve të rëndësishme përgjatë kësaj rruge ishte statio Vendenis, i cili është identifikuar pranë fshatit Gllamnik.<sup>18</sup> Këtë vendbanim e përmend Ptolomeu në shekullin II,<sup>19</sup> e më pastaj e gjejmë të shënuar si Vindenis në Tabula Peutingeriana<sup>20</sup> dhe si Vindinis, qytet i Ilirikut, te Anonimi i Ravenës.<sup>21</sup> Vendbanimi i Vendenisit ka një shterrirje të gjërë prej disa hektarësh, por ende të pahulumtuar. Në afërsi janë zbuluar varrezat me një kontinuitet kohor prej shekullit II e deri në shekullin VI. Në mesin e mbi 250 varreve ndeshen varrime në gropa, rrallë në arka prej druri, varre me çati të rrumbullaksuar e të tjera.<sup>22</sup> Sarkofagu prej mermeri i zbuluar më heret ofroi material të pasur, kryesisht stoli prej ari, në mesin e të cilave është me interes unaza me gemë, ku janë paraqitur dy duar të bashkuara dhe mbishkrimi: Omonia.<sup>23</sup> Poçaria e zbuluar në varreza riprodhon trajtat e njohura të kulturës provinciale romake, por, në mesin e tyre ndeshim dhe elemente të zbuqurimit të enës me instrument të dhëmbëzuar që janë shprehje e traditave parahistorike dardane dhe e prodhimit të mjesh-tërve poçar vendas. Në vendbanim janë zbuluar disa fragmente të shtyllave prej mermeri dhe kapitetele të shtyllave që dëshmojnë për aktivitetin ndërtimor në këtë vendbanim të kohës antike. Lulzimi i Vendenisit dëshmohet më së miri me prezencën e mozaikut të Orfeut dhe të kompozicioneve të tjera mozaikale të stilit gjeometrik përreth tij, të gjitha këto të zbuluara në një godinë me disa kthinë dhe me hipokaust (ngrohtore). Mozaiku polikrom i Orfeut<sup>24</sup> zbuquronte dyshtemenë e njerës prej kthinave të këtij kompleksi të gjërë arkitektonik. Kompozicioni mozaikal trajton mitin pagan mbi Orfeun dhe në të Orfeu është paraqitur me Lyrë dhe i rrethuar me shtazë. Sipas paraqitjes stilistike mozaiku në fjalë mund të datohet deri kah fundi i shekullit III dhe si i tillë është njeri ndër më të hershmit në Ballkanin qendror dhe në të njëjtën kohë është unik për nga paraqitja. Këto të dhëna dëshmojnë për aktivitetin e lulëzuar arkitektonik në trevat dardane, një kohë pas fitimit të rangut të municipiumit të Ulpianës, „urbs splendidissima”, në territorin e të cilit bënte pjesë edhe Llapi i sotëm.

<sup>18</sup> E. Çerškovi, *Rimljani na Kosovu i Metohiji*, Beograd 1969, 44.

<sup>19</sup> *Tabula imperii Romani K 34*, Lubjanë 1976, 132.

<sup>20</sup> *Ilirët dhe Iliria...*, 313.

<sup>21</sup> *v. c.*, 486.

<sup>22</sup> *Të dhëna nga hulumtimet e S. Fidanovskit* (Muzeu i Kosovës).

<sup>23</sup> E. Çerškovi, *v. c.*, fot. 14.

<sup>24</sup> E. Shukriu, *Mozaiku i Orfeut në Gllamnik*, Gjurmime albanologjike, XV, Prishtinë 1986, 289-298.

Zbulimi i mozaikut është shprehje e zhvillimit të artit, sidomos i atij mozaikal të dyshemeve në tokat dardane, në kohën e sundimit romak dhe në të njejtën kohë flet për vazhdimësinë e lidhjeve me botën greke. Të gjitha këto flasin për një kontinuitet të gjatë të banimit në Vendenis dhe për rëndësinë ekonomike dhe të reflektimit kulturor të tij gjatë shekujve.

Në Llap është zbuluar edhe një numër i konsiderueshëm i objekteve, të cilat dëshmojnë intenzitetin e jetës gjatë periodës romake, qendër e së cilës ishte Vendenisi antik. Në breg të lumit Llap, gjysmë kilometri në jug të Podujevës është zbuluar një arë, ndërsa në Dumnice të Poshtme u gjet ara e përkushtuar nymfave.<sup>25</sup> Arë e ngjashme e përkushtuar nymfave është zbuluar edhe në Gllanik dhe kjo, sa ka mundur t'i përkushtohet „Nymphae Salutares” të Bajës së Kurshumlisë,<sup>26</sup> aq ka mundur t'i përkushtohet „Deabus sacrum virginibus” të ujit termal të Sallabajës, jo larg Gllanikut. Në Uglar është zbuluar stella (plakë mbivarrore), në të cilën është shënuar edhe një emër femre, Nanea, emër ky i cili ndeshet shpeshherë tek ilirët dhe është karakteristik për trevën dardane.<sup>27</sup>

Gjatë antikitetit ruhen edhe traditat e mëhershme, të cilat pasqyrohen në veçoritë territoriale të kulturës provinciale romake. Tradita të tilla ndeshim në monumentet epigrafike, në emrat ilirë, siç ishte emri Nanea, në veshjet vendase të paraqitura në relievet e gurëve mbivarror (stella) apo në bysta siç është ajo e gruas nga Kllokoti, si dhe në ruajtjen e panteonit dardan dhe në paraqitjen e hyjnive si Andini e Dea e Dardanisë. Këto shpjegohen, pos me rrënjët e traditave, edhe me politikën joasimiluese të Perandorisë romake ndaj popullsisë vendase, qëllimi i së cilës ishte kryesisht përvehtësimi i pasurive natyrore. Veçoritë etnike dardane si duket ishin vendimtare kur gjatë reformave të Dioklecianit (shek. III), e pastaj të Konstantinit, u formua Dardania si provincë në vetë. Pavarësinë provinciale Dardania do ta mbajë deri në kohën e Justinianit të I-rë, kur, pas ndarjes së Perandorisë kjo bën pjesë në Ilirikun lindor. Territori i Llapit vazhdoi të jetë një lidhëse, e në këtë kuptim rol të rëndësishëm kishte edhe rruga, e cila shkonte rrjedhës së Batllavës e lidhej me at të lumit Jabllanicë e Moravë. Banorët e vendbanimeve përreth merreshin me blegtori e sidomos me eksploatimin e xeheve, zgurat e të cilave ndeshen në shumicën e lokaliteteve. Ndërhyrjet e fiseve nga kufijt verior të Perandorisë që më me intenzitet u bënë në shekujt IV e V e intensifikuan jetën në vendbanimet më të mbrojtura kodrinore. Vendbanimi i fortifikuar në Çukën e Brainës, me një konti-

<sup>25</sup> M. Garashanin, *Arheološki nalazi u Jugoslaviji*, Beograd 1951, 214

<sup>26</sup> E. Çerškov, v. c., 66.

<sup>27</sup> R. Katiçiq, *Savremena istraživanja o jeziku starosjedelaca ilirskih provincija*, Simpozium o teritorijalnom i hronološkom razgraničenju ilira u praistorijsko doba, Sarajevë 1964, 23; E. Çerškov, v. c., 62.

nuitet banimi që nga parahistoria,<sup>28</sup> e arrin lulëzimin e vet mu në kohën antike të vonë. Gjurmët e ruajtura të ledheve rrethonjëse me gjërësi prej 2 m, sistemi i dyfishtë i fortifikimit me kulla vrojtuese e mbrojtëse, kanë ngelë dëshmi e nevojës së kohës për mbrojtje të sigurt prej sulmeve nga jashtë dhe, në të njejtën kohë janë dëshmi e rritjes së vendbanimit dhe të rolit të tij gjatë antikitetit. Kjo fortifikatë është njëra prej 61 fortifikatave të rindërtuara në Dardani gjatë kohës së sundimit të Justinianit I (527-565), pas termetit katastrofal të vitit 518. Fortifikata ishte në lidhje të afërt me vendbanimin e së njejtës kohë të hulumtuar në Cariçin Grad afër Lebanit, ku u zbuluan, pos tjerash edhe godina të tipit bazilikal si dëshmi të ekzistimit të një qendre të rëndësishme krishtere. Nëse Cariçin Grad me siguri identifikohet si Iustiniana Prima, si mendojnë shumë dijetarë, atëherë ka mundësi që fortifikata e Brainës për shkak të afërsisë, të jet Bederiana, pranë së cilës, si thotë Prokopi, Justiniani në vendlindje e ndërtoi Iustiniana Prima-n.<sup>29</sup>

Ekzistimi i fortifikatave përgjatë rrugës që shkonte pranë rrjedhave të Batllavës e të Jabllanicës dëshmojnë për rëndësinë dhe për intenzitetin e jetës që u zhvillua pranë saj. Vendbanimi i Çukës së Batllavës apo të Drazhnjës ka mënyrë të ngjashme të ngritjes së ledheve rrethonjëse si në atë të Brainës. Eksploatimi i xeheve, si shihet nga zgurat e shumta e gropat sipërfaqësore, ishte veprimtaria më e rëndësishme ekonomike e banorëve të saj. Gjurmët e mihjeve janë ende të dukshme përreth fortifikatës, ku edhe sot eksploatohet argjendi, plumbi e zinku.

Kalaja e Ballocit është gjithashtu fortifikatë e antikës së vonë. Sipas gjurmëve të cilat i ka vërejtur dijetari Kanitz, e që duken edhe sot, ky ishte një kastell i cili mbronte rrugën Hammeum — Vicianum.<sup>30</sup> Fortifikata ngrihej rrëzë rrafshit të Llapit jo shumë larg bregut të majtë të lumit Llap. Ka mundësi që këtu të identifikohet fortifikata Laberion të cilën e shënon Prokopi si fortifikatë të re të ndërtuar nga ana e Justinianit. Sidoqë të jetë, është e sigurt se kjo fortifikatë hyn në listën e atyre fortifikatave të ndërtuara e jo të rindërtuara, pasi që që me rekognoscimin arkeologjik nuk janë ndeshur gjurmë të banimit më të hershëm të saj. Duket se edhe fortifikatën Besiana duhet kërkuar në ngjashmërinë etimologjike me emrin e fshatit Besi. Besiana, sipas Prokopit, ishte fortifikatë e rindërtuar, të tillë sot e ndeshim jo larg saj fortifikatën „Kulinë” të Teneshdolli. Vendbanim të fortifikuar me jetëzgjatje deri në mesjetë e ndeshim edhe në Kalanë në jugperëndim të Lupçit të Poshtëm.

<sup>28</sup> M. Garashanin, v. c., 214.

<sup>29</sup> *Ilirët dhe Iliria*..., 441.

<sup>30</sup> M. Garashanin, v. c., 214.

Kultura materiale e zhvilluar mbi bazat ekonomike është shprehje e kulturës dhe e botëkuptimeve të krijuara në kohëra të ndryshme. Në këtë trevë ndeshim gjurmë të kulturës materiale që pasqyrojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë botëkuptimet e krijuesve të tyre, duke filluar nga përhapja e kultit të Nënës Hyjneshë (Magna Mater), të kultit të strërgjyshërve, të politeizmit si hyjnitë ilire, hyu dardan Andini e Dea e Dardanisë, Zbletrudi trakas, hyjnitë greke, romake e orientale apo „interpretatio romana” të tyre e deri te dukja dhe zhvillimi i krishtëritimit. Sadoqë këto të fundit kanë koegzistuar në tre shekujt e parë, që nga shekulli IV, kur Perandoria romake e pranon si religjion shtetëror, krishtërimi bëhet religjion dominues edhe te dardanët. Përvehtësimi i krishtëritimit lidhet me kohën e sulmeve të pandërpëra nga veriu, të cilat shkaktuan frikë e pasiguri. Këto dhe kundërthëniet e brendëshme që lindën si pasojë e sistemit të vjetruar skllavopronar, e që si rrjedhim kishin paiteresimin për prodhimtari dhe vobeksimin e shtresave të gjëra, ishin disa prej shkaqeve që e shtyn popullsinë të kërkojë shpresë në gjirin e krishtëritimit. Që nga shekulli IV në Dardani u krijua një klerarki e zhvilluar kishtarë, e cila përmes qendrave të saja ndahej dhe ndihma shtetërore që shkonte në favor të popullarizimit të krishtëritimit. Kësaj i ndihmoi dhe përvehtësimi i ceremonialeve të religjioneve e të kulteve pagane, siç ishte për shembull festa e 25 dhjetorit. Kalimi i disa të drejtave të intervenimit juridik në duart e kishës poashtu e bënë këtë më autoritative në sytë e popullit. Që në shekullin IV Ulpiana ishte qendër e rëndësishme ipeshkviale. Në konçilin e vitit 342 të mbajtur në Serdica (Sofia) merr pjesë ipeshkvi „Machedonius a Dardania de Ulpianis”. Kjo do të thotë se përhapjen dhe përvehtësimin e krishtëritimit duhet kërkuar më heret. Fillimin e hershëm e dëshmon dhe shfaqja e dy martirëve të krishtëritimit, Florit dhe Laurit, gurëgdhendës nga Ulpiana të cilët u ndëshkuan, sepse e bënë bazilikë tempullin pagan. Zhvillimin e mëtejshëm të krishtëritimit në këto treva dhe rrënjosjen e tij e dëshmon pjesëmarrja e ipeshkëve të Ulpianës në konfliktet doktrinale të krishtëritimit, si ai i Palit në vitin 553 apo i arkipeshkvit monofizit Gergentit në shekullin VI. Aktiviteti i dendur i krerëve të krishterë, për të cilët flasin burimet e shkruara dhe themelet e bazilikave, të cilat i ndeshim, janë dëshmi të përvehtësimit të krishtëritimit nga dardanët. Themelet e kishave të antikës janë evidentuar edhe në pjesën jugperëndimore të Kalasë së Ballocit, më vonë në afërsi të fshatit Pollatë, ndërsa fakti i ekzistimit të tyre në Gllamnik, Brainë dhe i reflektimit shpirtëror, kulturor e politik nga ato është i pamohueshëm.

Sadoqë hulumtimet arkeologjike dhe ato multidisciplinare janë të mangëta në këtë trevë, gjurmët e kulturave që janë shtresuar në tokën e pllëshme të Llapit dhe në kodrat pranë majdaneve të pasura me xehe, dëshmojnë për pasurinë kulturore dhe për traditën parahistorike e historike të saj. Gërshetimi i kultu-

rave e kanë bërë këtë mikroregjion të hapur ndaj vlerave të reja. Krahas mëvetësisë, pasuria kulturore që u shtresua në të e që medoemos kërkon të hulumtohet dhe të dalë në shesh me vlerat e saja, e bënë këtë të jetë pjesë e vlerave të gjithmbarshme kulturore.

*Edi Shukriu*

## LA CULTURE MATERIELLE DE LA CONTREE DE LLAP DANS LA SON PREHISTOIRE ET SON ANTIQUITE

### Résumé

La contrée de Llap s'étend dans la partie centrale des Balkans dont une telle position géographique a servi comme un noeud important de routes soit dans la préhistoire ainsi qu'à l'antiquité.

Les ressources naturelles conditionnaient le placement des habitants. Nous trouvons les premières traces à l'époque néolite, respectivement la culture de Starçevë découverte à Sibovc. Depuis ce tempslà, cette contrée fait partie aux époques ultérieures dans le territoire tout entier de Kosovë.

Parmi les localités les plus importantes qui a eu une longue continuité d'habitation à partir de la préhistoire jusqu'à une époque tardive antique où se regroupent: la „Kulina” près de Teneshdoll et le „Çuka de Braine”. Comme centre à l'antiquité a été l'ancienne Vendenis, près Glamnik où on a fait des recherches concernant le Grand Néropol qui appartient aux siècles II-VI, et le complexe architectonique de ce lieu — là tandisqu'une place à part occupe la mosaïque d'Rhpée. Des puis de mines qu'on rencontre sur les collines fortifiées témoignent que les habitants s'occupaient des mines qui provenaient grâce à la prospérité culturelle tout au long de l'antiquité. Quoique ce soit, les recherches archéologiques et multidisciplinaires y manquent; les traces des couches de cultures dans la plaine près la rivière Llap et sur les collines des mines qu'on y rencontre pendant la reconnaissance archéologique témoignent bien qu'il y eut une richesse de cultures, une tradition préhistorique et historique de cette contrée.

